



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim kontrolli: FERRERO INTERNATIONAL S.A / STELLIFERI GROUP

Në datën 24 Korrik 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të Marrëveshjes së Investimit dhe të Ortakëve e nënshkruar ndërmjet shoqërive aksionere Ferrero International S.A, dhe grupit Stelliferi, më datë 30 Qershor 2012, me objekt përfitim, nga shoqëria Ferrero International S.A, të kontrollit të plotë të aktivitetit të prodhimit të lajthive e zotëruar nga grupi Stelliferi Business NAT si dhe të kontrollit të përbashkët (sëbashku me shoqërinë Mariano Stelliferi S.p.a) të aktivitetit të prodhimit të produkteve gjysmë të përpunuara të zotëruara nga grupi Stelliferi Business SL.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Ferrero International S.A:** ushtron aktivitet në mbarë botën në prodhimin dhe shitjen e ëmbëlsirave (psh. ëmbëlsirave prej çokollate, kamele, snacks dhe ëmbëlsirave në formë kremi);
- **Grupi Stelliferi:** ushtron veprimtarinë e saj në sigurimin e lajthive dhe tregtimin e lajthive (përfshirë lajthitë në gjendje natyrore dhe të produkteve gjysmë të përpunuara, si psh. miell dhe brum lajthie).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr "Sami Frashëri", Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al